

VENDIM
Nr. 1017, datë 16.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 280, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE TËRBUF, BASHKIA DIVJAKË, TË QARKUT TË FIERIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 280, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Bashkisë Divjakë i ndalohet të tjetërsojë pronën me numër rendor 796, me numër pasurie 479, në zërin kadastral "Kënetë", me vendndodhje në zonën kadastrale 3547, të përcaktuar në listën e inventarit bashkëlidhur vendimit."

2. Në vendimin nr. 995, datë 9.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 280, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shetëtore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Tërbuf të qarkut të Fierit", pika 2 shfuqizohet.

3. Ngarkohen Bashkia Divjakë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe